

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **203-24-8259-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Rrënimi i objekteve ku do të ndërtohet objekti i MBPZHR-së**

### A N K E S Ë

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

\_\_\_\_\_ **OE "VB HOLDING SH.P.K."** \_\_\_\_\_  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

\_\_\_\_\_ **Rr. "Hamdi Grajçevci, pn",** \_\_\_\_\_  
(Adresa)

\_\_\_\_\_ **Fushë Kosovë** \_\_\_\_\_ **12000** \_\_\_\_\_  
(Vendi) (Kodi postar)

\_\_\_\_\_ **+383 49611315** \_\_\_\_\_  
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

\_\_\_\_\_ **Valdet Mëziu** \_\_\_\_\_  
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

\_\_\_\_\_ **vbholding1@gmail.com** \_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_ **06.05.2025** \_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

Shëno të dhënat si në vijim:

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Ky aktivitet i prokurimit titullohet **“Rrënimi i objekteve ku do të ndërtohet objekti i MBPZHR-së”** dhe ka filluar me rastin e njoftimit për kontratë i cili është publikuar me datën 14.08.2024.

Afati për dorëzimin e tenderëve është ri-caktuar disa herë si pasojë e ndryshimit të dosjes së tenderit dhe tani pritet të bëhet me datë 07.05.2025

Të pakënaqur me kriteret e vendosura nga AK, me datë 30.04.2025 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim!

AK me datë 05.05.2025 e ka refuzuar Kërkesën tonë për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim o i drejtohem OSHP-së me këtë Ankesë.

Kriteri i vlerësimit është përcaktuar të jetë **Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.**

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

☐

Jo

☒

Hapja e tenderëve nuk është bërë akoma por që është e ri caktuar për datën 07.05.2025.

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

☐ N/A

Jo

☐ N/A

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

☒

Jo

☐

Afati për dorëzimin e tenderëve është ri-caktuar disa herë si pasojë e ndryshimit të dosjes së tenderit dhe tani pritet të bëhet me datë 07.05.2025

Të pakënaqur me kriteret e vendosura nga AK, me datë 30.04.2025 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim!

AK me datë 05.05.2025 e ka refuzuar Kërkesën tonë për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim o i drejtohem i OSHP-së me këtë Ankesë.

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

1. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,

2. AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP-001/2022,

3. AK ka shkelur nenin 51 të LPP-së,

4. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**Pretendimi 1:** AK ka shkelur nenin 7 të LPP-se pasi që gjatë hartimit të dosjes së tenderit përkatësisht gjatë hartimit të kriterëve kualifikuese për OE, por edhe gjatë ndryshimit dhe modifikimit të sajë në disa raste, ka vendosur kriterë kufizues të cilat qartë shihet se i'a ka përshtatur një ose disa OE të caktuar. Po ashtu, AK ka vendosur edhe kriterë tjera diskriminuese dhe kufizime të panevojshme që shumicës së OE ia pamundësojnë pjesëmarrjen në këtë tender. Ky veprim i AK-së bie ndesh me nenin 7 të LPP-së si dhe bie ndesh me nenin 27, 51 dhe 69 të LPP-së përkatësisht edhe me nenin 17 të RRPP-001/2022. Këto dispozita flasin qartë për detyrimin e AK-së në mos diskriminimin e OE, për hartimin e kërkesave relevante lidhur me natyrën e lëndës, për informata të sakta rreth projektit si dhe flasin edhe për natyrën tjetër të kërkesave përkatësisht për hartimin e mirëfilltë të dosjes së tenderit të cilat AK i ka shkelur të gjitha.

Krejt kjo konsiderohet favorizim i OE të caktuar dhe njëkohësisht edhe diskriminim i të tjerëve e që bie plotësisht ndesh me nenin 7 të LPP-së.

Pikat dhe kriteret kufizues më detalisht do ti përshkruajmë tek pretendimet tjera që lidhen drejt për drejt edhe me nenet e LPP-së dhe RRUOPP-së që ne pretendojmë se janë shkelur.

**Pretendimi 2:** AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP-001/2022 pasi që gjatë hartimit të dosjes përkatësisht hartimit të kërkesave për mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka vendosur shumë kriterë kufizues e në të njëjtën kohë ka lënë shumë kriter/elemente të rëndësishme pa i përcaktuar fare. Bazuar në këtë del që dosja e tenderit nuk është hartuar në përputhje me nenin 27 të LPP përkatësisht me nenin 17 të RRPP-001/2022. Ja si e përshkruan obligimin e AK-së në hartim të dokumenteve të tilla neni 17 i RRPP-001/2022:

**17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:**

- a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
- b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.

AK nuk e ka respektuar këtë andaj konstatojmë se gjatë ri hartimit disa herë të dosjes së tenderit, janë shkelur parimet bazë të prokurimit, neni 27 i LPP-së si dhe neni 17 i RRPP-001/2022. Detajet e shkeljeve i gjeni në vazhdim:

Në dosjen e tenderit për projektin në fjalë janë vendosur disa kërkesa të cilat duken qartë se nuk janë në përputhje me LPP dhe RRPP-001/2022 për natyrën e projektit, janë kërkesa të paqarta që lëjnë vend për manipulim gjatë procesit të vlerësimit si dhe nuk janë as proporcionale me madhësinë dhe volumnin e projektit. Në vazhdim po i renditim të gjitha pretendimet tona rreth kriterëve kufizues dhe jo proporcionale.

**Gabimi 1.** AK ka vendosur kërkesa për stafin të cilat i ka komplikuar qëllimisht duke mos e saktësuar se çka duhet ofruar për secilën kërkesë si dëshmi mbi përgatitjen dhe kualifikimin e tyre. **Ngatërrimin e ka bërë edhe në aspektin e sasisë ku diku thotë që kërkohet një person me një përgatitje të caktuar ndërsa në anën tjetër kërkon certifikata të tilla për tërë stafin punues.**

Krejt kjo është bërë qëllimisht me të vetmin qëllim që të ketë mundësi manipulimi gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve dhe të ua vështirësoj disa OE-ve sa më shumë punën e përgatitës së tenderëve të tyre. Edhe për këtë pjesë kanë dal informata se disa OE-ve veç u janë dhënë sqarime detale se me cilin staf duhet aplikua ndërsa për opinionin e gjerë publik kanë lënë kërkesa të pa qarta dhe të pasakta të cilat ka gjasë se do të do të keqpërdoren gjatë vlerësimit.

**Gabimi 2.** AK ka publikuar një formular për përmirësimin e gabimeve edhe pse tek ai formular nuk e ka shënuar asnjë nga ndryshimet e bëra por vetëm ka ndryshuar datën e tenderimit dhe ka theksuar se gjoja ndryshimet i gjeni tek dokumenti shtesë. Këtë pretendim e ka refuzuar tek vendimi për refuzim edhe pse tek dokumenti shtesë nuk i ka bërë të gjitha ndryshimet e duhura duke mos e bartur ndryshimin e tillë fare tek lista e çmimeve dhe tek Aneksi 1 në dosje të tenderit. Me rastin e nënshkrimit të kontratës dihet se ajo implementohet sipas listës së çmimeve, del që AK kot a publikuar një dokument të ndryshuar përderisa nuk e ka bërë pjesë të dosjes së tenderit e as pjesë të listës së çmimeve mbi bazën e të cilave implementohet kontrata.

Ligji e thotë shumë qartë se çdo ndryshim që bëhet apo pranohet nga pyetje përgjigjet dhe detyrimet e OSHP-së, duhet pasqyrohet tek formulari për korrigjimin e gabimeve dhe në dosje të tenderit gjë që AK nuk e ka bërë.

Të gjitha këto lëshime krijojnë keqkuptime gjatë procesit të aplikimit e sidomos do të krijojnë mundësi keqpërdorimi gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve ku dyshohet se AK qëllimisht i ka lënë si të tilla.

**Gabimi 3.** AK gjatë hartimit të dosjes së tenderit prap ka lënë paqartësi të madhe edhe tek sasia e punimeve që do kryhen e sidomos tek **Specifikimit Teknik** përkatësisht tek **Lista e Çmimeve** pasi që nuk ka përcaktuar as për së afërmi sasinë e punëve apo materialeve që do trajtohen. Kjo do të krijoj shumë probleme në përcaktim të kostos ofertuese e sidomos do të krijoj probleme gjatë implementimit të projektit.

Vlen të tregohet se gjatë vizitës në terren, pas matjeve paraprake, kemi vërejtur një mospërputhje të madhe mes sasive së ofruara nga autoriteti kontraktuese dhe situatës reale në terren. Për parcelën në fjalë, preferohet të ketë një përshkrim të detajuar të të gjitha sistemeve të ujësjellësit, rrjetit elektrik, rrjetit tjetër nëntokësor bashkë me objekte që ndodhen në sipërfaqe pasi të gjitha punimet që kërkohet të kryhen në atë zonë kanë rrezikshmëri të lartë dhe mund të ketë ndonjë shpërthim të papritur nëse këto informata nuk janë të qarta dhe të bashkangjitura në formë të skicave të sakta dhe të detajuara.

Për rrjetin elektrik, preferohet të ketë një përshkrim të detajuar, pasi shumica e asaj zone furnizohet nga ai rrjet i energjisë elektrike dhe mund të ketë detaje të pakontrolluara që mund të shkaktojnë probleme serioze dhe mosrealizim të kontratës. Edhe pse AK ka dhënë një lloj sqarimi, prap të dhënat e tilla nuk janë të mjaftueshme për të kuptuar sasinë e punës që të kemi mundësi të përcaktojmë një çmim real për koston e largimit dhe trajtimit të tyre!

Gjithashtu, i gjithë rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimeve për komunitetin përreth është i lidhur me këtë pjesë. Sipas paramasës, duhet të bëhet zhvendosja e tij. Bazuar në këtë AK duhet të siguroj një plan të detajuar për zhvendosjen dhe llojet e punimeve që do të kryhen këtu, pasi kemi shumë paqartësi në paramasë për çka edhe mund të lindin keqkuptime të mëdha gjatë zbatimit.

Edhe objektet që ndodhen në këtë zonë, siç janë pompat e derivateve, kanë rrezikshmëri të lartë

dhe kërkohet të ketë një përshkrim detal të rrjetit nëntokësor të tyre për zhvendosjen e rezervuarëve ose pajisjeve të ndryshme që janë shumë të rrezikshme dhe mund të shkaktojnë dëme të mëdha dhe të paparashikueshme. Informacioni që gjoja OE do duhet të kryejnë punime deri në **50cm** thellësi është gabim pasi që aty sipas asaj që ne kemi parë se kemi raste dhe vende ku elementet që duhet rrënuar dhe larguar janë deri në 20m nën sipërfaqen e tokës. Këtu shtrohet pyetja se a duhet të largohen materialet që ndodhen më thellë se sa një Bodrum pasi që AK ka thënë që punimet bëhen diku në (B+P+2) ku zakonisht lartësia bodrumit apo etazheve është 2.5-3 metër e diku ka konstatua se do punohet vetëm deri në thellësinë 50cm, apo duhet larguar vetëm ato që janë deri në 20 metra thellësi? Kjo thellësi e materialeve dhe objekteve vjen për shkak të disnivelit të zonës gjë të cilën AK askund nuk e ka paraqitur andaj është vështirë të përcaktohet me këto të dhëna vlera reale e koston së projektit për një OE. Ja si duket pozicioni 1.2 për këto demolime dhe largime që len hapësirë të madhe për manipulim:

**Demolimi i kontrolluar dhe largimi I materialit deri ne deponin sanitarë (ose deponi ricikluese) -** deponimi dhe largimi I te gjitha strukturave solide (asfalt me nënshtresa; Beton sipërfaqësor me nënshtresa; objekte nga metali, objekte nga guri dhe te gjitha materialet solide egzistuese sipërfaqësorë duke i llogaritur në thellësi max. 50cm. Paraprakisht para ofertimit per kete pozicion te behet vizita ne teren.

Paramendo, tërë demolimin, demontimin dhe largimin në formë të kontrolluar të infrastrukturës dhe objekteve në një hapësirë aq të madhe e ka vendosur vetëm në katër pozicione për çka do jetë e pamundur që të ofrohet një çmim i saktë i koston së punës së tillë. Për tërë ato punime që realisht duhet të bëhet, është dashur të shpërndahet së paku në 30 pozicione veç e veç sepse vetëm ashtu AK do bënte realizim të mirëfilltë të projektit dhe shpenzim efikas, efektiv dhe ekonomik të mjeteve të parashikuara për këtë qëllim.

Ne kemi informacione se AK qëllimisht prap po i fshehë informata e tilla për publikun ndërsa disa nga OE-ve tani më veç u janë shpërndarë shënime të sakta për volumin e punimeve që do kryhen. Kjo është e ndaluar prandaj kërkohet që specifikimi teknik bashkë me projektin të jenë të sakta. Edhe shënimi që gjoja bashkë me dosje do jepet edhe projekti detal është vetëm si informatë në letër sepse askund nuk ka ndonjë projekt detal të bashkangjitur në dosjen e tenderit.

Sipas kësaj të gjitha kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale si dhe të gjitha përshkrimet e punimeve që do kryhen janë të hartuara jo mirë, posedojnë kufizime dhe favorizime, lënë vend për keqkuptime dhe keqpërdorime si kriterë, të cilat në të njëjtën kohë bien ndesh edhe me kërkesat e nenit 69 të LPP-së. Nisur nga kjo lirisht mund të themi se AK ka shkelur plotësisht nenin 27 të LPP-së si dhe 17 të RRPP-001/2022 dhe ndryshimi i shumëfishtë i dosjes së tenderit është vetëm arsyetim që gjoja ne po duam ta bëjmë dosjen mirë dhe sipas ligjit. Në fakt, secilën herë që është ndryshuar dosja e tenderit, vetëm sa është komplikuar më shumë.

**Bazuar në këtë kërkesë nga AK që ta anuloj komplet procedurën, të angazhohet në hartim të një projekti detal të punimeve dhe të fillojmë një procedurë të re sepse ky projekt në këtë formë tashmë e ka humb kuptimin me ndryshime të shumëfishta që janë bërë.**

Mbështetur në krejt këtë, kërkesë gjithashtu që kriteret në fjalë të rregullohen dhe të përshtatet me praktikën e mira të prokurimit si dhe të vendosen vetëm kërkesa proporcionale me projektin

dhe natyrën e tijë.

**Pretendimi 3:** AK ka shkelur edhe nenin 51 të LPP pasi që gjatë përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes sepse siç e sqaruar në pretendimin e mësipërm ka përcaktuar kriterë dhe kërkesa jo relevante, jo proporcionale dhe jo të sakta në krahasim me projektin fjalë. Ja si e përshkruan pika 3 e këtij neni këtë obligimin e AK-së gjatë hartimit të kriterëve në projekte të tilla:

**Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.**

Bazuar në këtë dhe në sqarimet e mësipërme shihet se AK e ka shkelur nenin 51.3 të LPP-së gjatë hartimit të kësaj dosjeje të tenderit për faktin se ka ofruar ekstrem pak informata mbi gjendjen reale në teren e sidomos të infrastrukturës nëntokësore.

**Pretendimi 4:** AK ka shkelur gjithashtu nenin 69 të LPP-së me rastin e përcaktimit të kërkesave lidhur me **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale** pasi që ka kërkuar dëshmi që përpos që janë në kundërshtim me dy nenet e cekura, nuk janë fare proporcionale me natyrën e projektit që parashihet të realizohet përmes kësaj procedure. Sqarimet se në cilat pika është shkelur neni në fjalë janë dhënë tek pretendimi 1 dhe 2 andaj kërkojmë që ato kërkesa të përmirësohen dhe të sillen brenda normave ligjore të përcaktuar me ligj.

Në bazë të kësaj konstatojmë se AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 69 të LPP dhe si rrjedhojë gjatë hartimit të dosjes së tenderit edhe e ka shkelur ligjin dhe nenin në fjalë.

Bazuar në krejt këtë që theksuam më lart kërkojmë nga OSHP që të merr:

#### **V E N D I M**

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e OE “VB HOLDING SH.P.K.” lidhur me tenderin “**Rrënimi i objekteve ku do të ndërtohet objekti i MBPZHR-së**”.

**ANULOHET** njoftimi për kontratë i AK - **MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL.**

**AK të detyrohet që të anuloi komplet procedurën** sepse u ngatërrua aq shumë sa që s’ka mundësi më të shkohet duke u modifikuar, prandaj gjatë ri tenderimit duhet të angazhohet seriozisht që të eliminoj kërkesat kufizuese nga dosja e tenderit, të vendos kërkesa proporcionale me projektin, të vendos kërkesa të qarta që nuk krijojnë dykuptimësi në plotësim dhe vlerësim, e më pas të vazhdohet me procedurën në fjalë. Gjithashtu të rishikohen të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit duke i harmonizuar ato me LPP-në dhe RRPP-001/2022 si dhe duke ia përshtatur natyrës së projektit, procedurës si dhe shpenzimit efikas dhe efektiv të parasë publike si dhe masave reale të terrenit.
















## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk na mundësohet aplikimi në këtë tender janë të konsiderueshme si në fushën financiare përfshi këtu fitimet e munguara, dhe mos mundësinë e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

-  1 Njoftim per Kontrat
-  2 Dosja e Tenderit
-  3 Projekti i Rrenimit
-  4 Paramasa
-  5 Pergjigja në kerkesen per sqarime shtesë
-  6 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
-  7 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
-  8 Dosja e Tenderit e korrigjuar 17.01.2025
-  9 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
-  10 Dosja e Tenderit 25.04.2025
-  11 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve 28.04.2025
-  12 Paramasa e pa ndryshuar
-  13 Sqarime per Instalimet Elektrike dhe Hidroinstalimet 25.04.2025
-  14 Kerkese për Rishqyrtim - 30.04.2025
-  15 Shqyrtimi i kerkeses per rishqyrtim te OE-së

**Vërejtje:** Të gjithë materialin në të cilin i kemi mbështetur pretendimet tona, e gjeni të bashkangjitur por edhe në materialin e procedurës së prokurimit që ndodhet në AK.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*